

VENDIM
Nr.1275, datë 24.9.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 25 shtator 2008, të dy autokolonave dhe trupave ushtarake italiane, të përbëra, si më poshtë vijon:

- a) Autokolona e parë, me 11 (njëmbëdhjetë) automjete dhe 13 (trembëdhjetë) trupa;
- b) Autokolona e dytë, me 13 (trembëdhjetë) automjete dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) trupa.

2. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 26 shtator 2008, të tri autokolonave ushtarake italiane, të përbëra, si më poshtë vijon:

- a) Autokolona e parë, me 14 (katërmëdhjetë) automjete dhe 28 (njëzet e tetë) trupa;
- b) Autokolona e dytë, me 15 (pesëmbëdhjetë) automjete dhe 30 (tridhjetë) trupa;
- c) Autokolona e tretë, me 15 (pesëmbëdhjetë) automjete dhe 30 (tridhjetë) trupa ushtarake.

3. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 27 shtator 2008, të dy autokolonave ushtarake italiane, të përbëra, si më poshtë vijon:

- a) autokolona e parë, me 11 (njëmbëdhjetë) automjete dhe 13 (trembëdhjetë) trupa;
- b) autokolona e dytë, me 13 (trembëdhjetë) automjete dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) trupa.

4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit.

5. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

6. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

7. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha